



Funded by
the European Union



BASHKIA
ELBASAN



URBAN
RESEARCH
INSTITUTE



Energjia e gjelbër dhe e qëndrueshme në ndërtesat e Elbasanit

Kurseni Energjinë në Shtëpi



Udhëzues për Eficiencën dhe Kursimin e Energjisë në Familje
Këshilla dhe masa të thjeshta për familjet në Elbasan për të ulur
konsumin e energjisë dhe kostot e faturave.

Bashkia Elbasan | Instituti i Kërkimeve Urbane

Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit SGA NZC 101121530 - Subgrant - PCP3 - Elbasan, “Energji e Gjelbër dhe e Qëndrueshme në Ndërtesat e Elbasanit”, 2024–2026. Projekti zbatohet nga Bashkia Elbasan dhe Instituti i Kërkimeve Urbane në kuadër të aktivitetit A1.2.4 “Hartimi i Udhëzuesit për Efiçencën e Energjisë”.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e Institutit të Kërkimeve Urbane. Instituti i Kërkimeve Urbane nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet përmbajtjes së këtij publikimi nga palë të treta.

Përgatitur nga:

Instituti i Kërkimeve Urbane

Mars 2026

© 2026 Instituti i Kërkimeve Urbane

Rruga e Barrikadave,

Pall 14 K, Kati 4, Ap. 44, Tiranë 1057

www.uri.org.al

Disa të drejta të rezervuara.

Ky publikim është objekt i së drejtës së autorit. Duke qenë se Urban Research Institute inkurajon shpërndarjen e njohurive dhe materialeve informuese, përmbajtja e këtij publikimi mund të riprodhohet, tërësisht ose pjesërisht, për qëllime jokomerciale, me kusht që burimi të citohet në mënyrë të plotë dhe të qartë.

Tabela e Përmbajtjes

01	Çfarë është ky udhëzues dhe pse u hartua?
02	Metodologjia dhe zgjedhja e 6 zonave prioritare
03	Ndriçimi - humbjet dhe si i zvogëlojmë ato?
04	Ngrohja dhe Ftohja - humbjet dhe zgjidhjet
05	Dritaret dhe Çarjet - si humb nxehtësia?
06	Uji i Nxehtë - rregullimi dhe kursimi
07	Pajisjet dhe Standby - energjia e fshehur
08	Kuzhina - zakonet e vogla me ndikim të madh
09	Quiz dhe Sfida - Sa e njoh shtëpinë time?
10	Plani im i veprimit dhe komente
11	Referenca

Kujt i shërben ky udhëzues?



*Figura 1. Shembull banesash kolektive në zonën e studimit, Lagjja Vullnetari, Elbasan.
Burimi: Studim mbi sjelljen e konsumit të energjisë në Elbasan - Projekti GreenElb*

Ky udhëzues u shërben familjeve në Elbasan që dëshirojnë të kuptojnë më mirë konsumin e energjisë në shtëpitë e tyre dhe të ndërmarrin hapa të thjeshtë për ta përdorur atë në mënyrë më efikase.

Ai është i dobishëm për çdo familje, pavarësisht llojit të banesës, nivelit të të ardhurave apo njohurive teknike, duke ofruar këshilla praktike për reduktimin e humbjeve të energjisë, uljen e faturave dhe përmirësimin e komoditetit në banesë.

Udhëzuesi synon të ndihmojë familjet të marrin vendime të informuara për përdorimin e energjisë, të adoptojnë zakone më efikase dhe të identifikojnë masa të thjeshta që mund të sjellin përfitime ekonomike dhe mjedisore në afatgjatë.

Metodologjia

Studimi i sjelljes së konsumit të energjisë në familjet e Elbasanit u bazua në një kombinim metodash kërkimore, duke përfshirë intervista dhe anketa, vizita në terren, vëzhgime të banesave, analizë të konsumit energjetik dhe zhvillimin e 5 fokus grupeve me qytetarë. Kjo qasje mundësoi identifikimin e zakoneve të përdorimit të energjisë, faktorëve që ndikojnë në konsum dhe mundësive për përmirësimin e eficiencës energjetike në nivel familjar.

METODAT E HULUMTIMIT



Vizita në terren

Vlerësim i drejtpërdrejtë i banesave dhe kushteve të jetesës.



Intervista me familjet

Diskutime të strukturuar me 108 familje pjesëmarrëse.



Analiza e konsumit

Vlerësim i faturave dhe modeleve të shpenzimit energjetik.



Vëzhgimi i banesave

Inspektim i sistemeve të ngrohjes, izolimit dhe pajisjeve.




Si e përdorin familjet në Elbasan energjinë?

Studim u realizua për të kuptuar më mirë mënyrën se si familjet në Elbasan konsumojnë energjinë në banesat e tyre dhe për të identifikuar mundësitë praktike për kursim.

Procesi përfshiu planifikimin e metodologjisë, hartimin e pyetësorëve, mbledhjen e të dhënave në terren përmes anketimit të 108 familjeve, analizën e sjelljeve të konsumit dhe përgatitjen e gjetjeve kryesore me rekomandime konkrete. Rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e familjeve përballen me mungesë izolimi të mjaftueshëm, përdorim joefikas të bojlerëve dhe lënie të pajisjeve në gjendje standby. Këto praktika ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e konsumit të energjisë dhe të kostove familjare.

PROCESI I STUDIMIT



GJETJET KRYESORE

78%
e familjeve nuk kanë izolim të mjaftueshëm

65%
përdorin bojler mbi 60°C

45%
lënë pajisjet në standby




Studimi tregon se ndërhyrje të thjeshta mund të kursejnë 15–25% të energjisë në çdo familje.

Pse janë zgjedhur këto 6 zona?

Ku humbet më shumë energji në shtëpi? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, studimi identifikoi gjashtë fusha prioritare ku familjet kanë potencialin më të madh për të kursyer energji. Këto zona u përzgjedhën sepse ofrojnë mundësi konkrete për veprim, shpesh pa investime të mëdha, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e faturave mujore. Më poshtë mund të eksploroni secilën prej tyre dhe të zbuloni se ku mund të bëni diferencën më të madhe.


Çfarë tregoi studimi?

6 Zonat Prioritare



Studimi në lagjen Vullnetari tregoi se konsumi i energjisë përqendrohet kryesisht në ngrohje dhe ftohje (50%), ndriçim (15%) dhe ujin e ngrohtë (12%) - tre zonat që së bashku përbëjnë mbi 75% të faturës totale.

Secila zonë ofron mundësi konkrete kursimi, nga 10% deri në 75%, me masa të thjeshta që çdo familje mund t'i zbatojë vetë.



Zakonet që ulin faturën e energjisë

Fokusimi në këto 6 zona i ndihmon familjet të ulin konsumin e energjisë, të përmirësojnë komoditetin e banesës dhe të reduktojnë kostot mujore.

Zona 1: Ndriçimi

Ndriçimi është një nga mënyrat më të thjeshta për të ulur konsumin e energjisë në shtëpi. Zvendësimi i llampave jo efikente me LED sjell ndryshime të menjëhershme dhe përmirëson cilësinë e ndriçimit.



Figura 2. Llambë tradicionale / Led

Si të kontrolloni nëse keni nevojë për ndërimin

1. Shiko llambën - nëse është rrumbullake me filament të dukshëm, është inkandeshente dhe duhet ndërruar.
2. Kontrolllo vatët - nëse shkruan 40W, 60W ose 100W, konsumon shumë më tepër se nevojitet.
3. Ngjyra e dritës - nëse drita është shumë e verdhe dhe e dobët, llamba është joeficiente.
4. Nxehhtësia - nëse llamba nxehet pas 5 minutash, 90% e energjisë shkon si nxehësi jo si dritë.

Nëse ploteson një kriteret më lartë - ndërroje me LED 9W



Zëvendësoni llambat e vjetra me LED

Llambat LED konsumojnë deri në 75% më pak energji dhe zgjasin 15-25 herë më shumë.

- ✓ Konsum më i ulët
- ✓ Jetëgjatësi më e madhe
- ✓ Më pak mirëmbajtje



Kursimi deri në 75%

Llamba LED konsumon deri në 75% më pak energji se llamba tradicionale. Një familje mesatare mund të kursejë deri në 1,500 LEK/muaj vetëm duke ndërruar llambat.


Si ta zvogëlojmë konsumin e energjisë nga ndriçimi?

4 veprime praktike që mund t'i ndjekësh për të ulur konsumin e energjisë nga ndriçimi

01

Përdorni dritën natyrale

Hapni perdet dhe shfrytëzoni dritën e ditës sa herë që është e mundur.



02

Fikni dritat në dhomat bosh

Fikni dritat kur dilni nga një dhomë. Konsum zero kur nuk përdoret.



03

Vendosni sensorë lëvizjeje

Ideale për korridore, hyrje, pallate dhe ambiente që përdoren vetëm herë pas here.



04

Pastroni trupat ndriçues

Pluhuri ul ndriçimin deri në 20%. Mbajtja e pastër rrit efikasitetin e ndriçimit.



Zona 2: Ngrohja dhe Ftohja

Auditimi energjetik tregoi se banesat në lagjen Vullnetari konsumojnë më shumë energji sesa është realisht e nevojshme. Megjithatë, një pjesë e këtij konsumi mund të reduktohet përmes veprimeve të thjeshta, pa investime të mëdha.

Potenciali i kursimit

Deri në 30% kursim i mundshëm në faturën vjetore të energjisë

Ky kursim mund të arrihet përmes përdorimit më efikas të pajisjeve elektrike, rregullimit të temperaturave të ngrohjes dhe ftohjes, si dhe përmirësimit gradual të pajisjeve me klasa më të larta energjetike.


Pajisjet me efikasitet të lartë

Përdorimi i pajisjeve me klasë energjetike A+ / A++ ndihmon në uljen e konsumit të energjisë, sidomos për pajisjet që përdoren çdo ditë, si frigoriferi, lavatriçja, kondicioneri, bojleri dhe ndriçimi.

Sa konsumon familja jote?

Të dhënat bazohen në faturat reale të familjeve të audituara në lagjen Vullnetari, Elbasan, për periudhën 2026.

Konsumi mesatar sipas madhësisë së familjes



 A++ Kondicioneri Ngrohje / Ftohje	 A++ Pompa e nxehtësisë Ngrohje / Ftohje	 A+ / A++ Ngrohësi elektrik Ngrohje	 A+ Ventilatori Ftohje
--	--	--	--

Cilat janë temperaturat e rekomanduara për ngrohje dhe ftohje në banesë?

Sezoni	Temperatura Optimale	Kursimi i Mundshëm
 Dimër - Ngrrohje	19 - 21°C	deri 18%
 Verë - Ftohje	25 - 26°C	deri 12%
 Stinë Kalimtare	Pa sistem aktiv	100% kursim

Burimi: Ligji Nr. 124/2015 për Efiçencën e Energjisë.

Në stinët kalimtare, shmangni përdorimin e kondicionerit ose ngrohësve elektrikë kur temperatura e jashtme është e përshtatshme. Ajrosja natyrale, përdorimi i dritës së diellit dhe mbyllja e dritareve gjatë orëve më të ftohta mund të ruajnë komfortin pa konsum energjie.

Gjatë verës, vendosja e kondicionerit në 25–26°C ul konsumin dhe shmang mbingarkesën e pajisjes. Diferenca shumë e madhe ndërmjet temperaturës së jashtme dhe asaj të brendshme rrit faturën dhe ul efikasitetin.

Gjatë dimrit, temperatura 19–21°C konsiderohet më efikase për ngrohje të qëndrueshme. Çdo gradë më e lartë rrit konsumin, sidomos në banesat me izolim të dobët.

Me veprime të thjeshta, familjet mund të kursejnë deri në 30% të faturës së energjisë, pa humbur komoditetin në banesë.




Si ta zvogëlojmë konsumin e energjisë nga ngrohja dhe ftohja?

4 veprime praktike për të ulur konsumin e energjisë nga ngrohja dhe ftohja

01

Vendos temperaturën e duhur

Ngrohja në 19-21°C në dimër dhe ftohja në 25-26°C në verë sigurojnë komodit dhe kursim.



02

Mirëmbajtja e rregullt

Pastro filtrat dhe bëj kontrollin e pajisjeve për efikasitet maksimal dhe jetëgjatësi më të madhe.



03

Izolimi i mirë i banesës


Izolimi i mureve, dritareve dhe dyerve parandalon humbjet e nxehtësisë dhe përmirëson efektin e ngrohjes/ftohjes.



04

Shfrytëzo pajisje efikase

Pajisjet me etiketë energjetike A++ konsumojnë më pak energji dhe ofrojnë performancë më të lartë.



MBAJ MEND!

Masa të thjeshta si vendosja e temperaturës optimale, mirëmbajtja e rregullt dhe izolimi i banesës sjellin kursime të mëdha pa ulur komoditetin.

Zona 3: Dritaret & Çarjet

Deri në 20–30% e energjisë humbet nga dritaret

Dritaret e vjetra me tek xham dhe të çarat e paizoluara lejojnë hyrjen e ajrit të ftohtë dhe daljen e nxehtësisë nga banesa. Kjo rrit konsumin e energjisë për ngrohje dhe e bën shtëpinë më pak të rehatshme gjatë dimrit.

Çfarë ndodh nëse dritaret nuk janë të izoluara mirë?

Ajri i ftohtë futet nga të çarat pranë dritareve, dyerve dhe mureve. Në shumë raste, humbja e nxehtësisë nga dritaret e vjetra është e ngjashme me mbajtjen e një dritareje pak të hapur gjatë dimrit. Izolimi i tyre është një nga masat me efektive dhe me kosto të ulët.

**Kontrolloni
dritaret dhe
dyert**

**Vendosni
silikon në të
çarat**

**Përdorni shirit
izolues**



Ndërhyrje profesionale

Nëse dritaret janë shumë të vjetra, ndërhyrjet profesionale ose zëvendësimi i tyre mund të sjellin kursim më të madh.

**Izolim më i mirë i dritareve
Mund të sjellë kursim deri në 20 –30%, veçanërisht në banesat me dritare të vjetra.**



MBAJ MEND!

Mbyllja e mirë e dritareve dhe të çara ve është një nga masat më të thjeshta dhe më të lira për të kursyer energji në shtëpi. Para se të mendoni për zëvendësim, filloni me silikon, shirit izolues dhe kontroll të hapësirave ku hyn ajri i ftohtë.

Si të përmirësojmë izolimin e dritareve dhe të çarave?

Hapat kryesorë që mund të ndiqni në shtëpi



1. Përdorni silikon ose tape izoluese

Për dritaret ose dyert që nuk mbyllen mirë, përdorni shirit izolues. Ai vendoset lehtë dhe ndihmon në reduktimin e humbjeve të energjisë, sidomos gjatë muajve të ftohtë.



2. Përdorni perde të trasha

Perdet e trasha ndihmojnë që nxehtësia të qëndrojë më gjatë brenda gjatë dimrit. Gjatë verës, ato mund të ndihmojnë edhe në mbajtjen e freskisë, duke ulur nevojën për përdorim të tepërt të kondicionerit.



3. Kontrolloni dhe mbyllni çarat

Izolimi nuk duhet kontrolluar vetëm një herë. Para dimrit dhe gjatë periudhave të ftohta, kontrolloni përsëri dritaret, dyert dhe çarjet për të parë nëse ka nevojë për riparime të vogla.



4. Konsultohuni me specialist

Nëse dritaret janë shumë të vjetra, kanë xham tek ose nuk mbyllen mirë, këshillohuni me një profesionist. Ai mund të propozojë zgjidhje më afatgjata, si riparimi i kornizave, përmirësimi i mbylljes ose zëvendësimi i dritareve.



15%

Përfitimi kryesor

Izolimi i mirë i dritareve, dyerve dhe çarave mund të ulë konsumin e energjisë deri në 15%. Kjo do të thotë më pak humbje nxehtësie, më shumë rehati në banesë dhe fatura më të ulëta për familjen.

Zona 4: Uji i Ngrohtë

Si të përdorim bojlerin elektrik në mënyrë më ekonomike?

Në lagjen Vullnetari, uji i ngrohtë në banesa sigurohet kryesisht nga bojleri elektrik 80 litra. Kjo do të thotë se çdo përdorim i ujit të ngrohtë ndikon drejtpërdrejt në faturën e energjisë elektrike.

Kapaciteti i bojlerit

80 litra

Fuqia elektrike

1.8 - 2.2 kW

Burimi i energjisë

100% elektrik

Burimi: Raporti i Auditimit Energjitik, PC Store Sh.p.k., Lagjja Vullnetari, Bashkia Elbasan, 2025.



4 masa të thjeshta për të kursyer energji

■ Vendosni timer për bojlerin

Mos e lini bojlerin ndezur gjatë gjithë ditës dhe natës. Një matës kohe i thjeshtë mund ta ndezë bojlerin vetëm në oraret kur familja ka nevojë për ujë të ngrohtë, për shembull në mëngjes ose në mbrëmje.

■ Vendosni temperaturën në nivelin optimal

Termostati i bojlerit duhet të vendoset zakonisht në 55 – 60°C. Temperaturat më të larta nuk janë të nevojshme për përdorim të përditshëm dhe rrisin konsumin e energjisë.

■ Pastroni bojlerin rregullisht

Bojleri duhet kontrolluar dhe pastruar të paktën një herë në vit. Gëlqerja që grumbullohet brenda bojlerit e bën pajisjen të punojë më shumë për të ngrohur të njëjtën sasi uji.

■ Izoloni tubat e ujit të ngrohtë

Nëse tubat që çojnë ujin e ngrohtë nga bojleri drejt çezmës janë të paizoluara, një pjesë e nxehtësisë humbet gjatë rrugës. Izolimi i tubave ndihmon që uji të mbërrijë më i ngrohtë dhe më shpejt.

MBAJ MEND!




Bojleri që qëndron ndezur 24 orë konsumon energji edhe kur askush nuk përdor ujë të ngrohtë. Ndryshimi më i thjeshtë që mund të bëjë një familje është përdorimi i një timer-i dhe vendosja e temperaturës në nivelin 55 - 60°C. Këto masa nuk kërkojnë investim të madh, por mund të ulin ndjeshëm konsumin e energjisë.

Zona 5: Pajisjet & Standby

Si të shmangim energjinë e humbur nga pajisjet shtëpiake?

Shumë pajisje elektrike vazhdojnë të konsumojnë energji edhe kur duken të fikura. Ky quhet konsum në standby. Ai nuk sjell asnjë përfitim për familjen, por rrit faturën mujore dhe vjetore të energjisë.

Duke menaxhuar pajisjet në standby, mund të kurseni deri në 10% të energjisë së shtëpisë.



Si të shmangim energjinë e humbur nga pajisjet shtëpiake?

Fikni plotësisht pajisjet

Mos i lini pajisjet në standby kur nuk i përdorni. Televizori, kompjuteri, dekoderi, printeri, konsolat dhe pajisje të tjera elektronike vazhdojnë të konsumojnë energji edhe kur janë “të fikura” nga telekomanda.

Përdorni prizë me ndërprerës

Një prizë me ndërprerës ju lejon të fikni disa pajisje njëkohësisht. Kjo është veçanërisht e dobishme për zonën e televizorit, kompjuterit ose pajisjeve të zyrës në shtëpi.

Kontrolloni rregullisht pajisjet e lidhura

Shumë pajisje mbeten në prizë pa qenë të nevojshme. Karikuesit, mikrovala me orë dixhitale, printerët dhe pajisjet e vogla mund të konsumojnë energji gjatë gjithë ditës.

Zëvendësoni pajisjet e vjetra

Pajisjet e vjetra zakonisht konsumojnë më shumë energji, edhe gjatë përdorimit normal, por edhe në standby. Kur blini pajisje të reja, zgjidhni modele me efikasitet të lartë energjetik.

Si të shmangim energjinë e humbur nga pajisjet shtëpiake?

Kjo checklist ndihmon familjet të kontrollojnë pajisjet që konsumojnë energji në standby. Përdoreni si kujtesë para gjumit ose kur dilni nga shtëpia, për të fikur plotësisht pajisjet dhe për të hequr nga priza ato që nuk nevojiten.



Checklist për familjet

Çfarë duhet shmangur për të ulur konsumin nga standby?

 Çfarë duhet shmangur	 Pse është problem?	 U kontrollua?
1.  Të lini televizorin në standby gjatë natës	 Konsumon energji edhe kur nuk përdoret	☐
2.  Të lini dekoderin, modem-in ose konsolën ndezur pa arsye	 Janë pajisje që konsumojnë gjatë gjithë kohës	☐
3.  Të lini karikuesin në prizë pa telefon të lidhur	 Harxhon energji pa asnjë përfitim	☐
4.  Të lini kompjuterin ose laptopin në gjendje 'sleep' për shumë orë	 Nuk është fikje e plotë dhe vazhdon konsumin	☐
5.  Të lini printerin ose pajisjet e zyrës ndezur gjithë ditën	 Konsumojnë energji edhe kur nuk përdoren	☐
6.  Të mbani mikrovalën në prizë vetëm për orën dixhitale	 Ora qëndron aktive gjatë gjithë ditës	☐
7.  Të përdorni pajisje shumë të vjetra dhe joefikase	 Konsumojnë më shumë energji se pajisjet e reja	☐
8.  Të mos kontrolloni pajisjet para gjumit ose kur dilni nga shtëpia	 Energjia humbet pa u vënë re	☐



Zona 6: Kuzhina

Si të kursejmë energji gjatë gatimit dhe përdorimit të pajisjeve?

Kuzhina është një nga zonat ku energjia përdoret çdo ditë, për gatim, ruajtjen e ushqimit, larjen e enëve dhe përdorimin e pajisjeve elektrike. Me disa zakone të thjeshta, familjet mund të ulin konsumin e energjisë pa ndikuar në komoditetin e përditshëm.

Si të shmangim energjinë e humbur në kuzhinë?

Gatuani me kapak

Gjatë gatimit, përdorni gjithmonë kapak kur është e mundur. Kapaku ruan nxehtësinë brenda enës, shkurton kohën e gatimit dhe ul konsumin e energjisë.

Përdorni enë me diametër të përshtatshëm

Zgjidhni enë që përputhen me madhësinë e pllakës ngrohëse. Kur ena është shumë e vogël ose shumë e madhe për pllakën, një pjesë e nxehtësisë humbet.

Përdorni furrën me efikasitet

Kur përdorni furrën, përpikuni të gatuani më shumë ushqime njëherësh dhe shmangni hapjen e shpeshtë të derës. Çdo hapje e derës ul temperaturën dhe e detyron furrën të konsumojë më shumë energji për t'u ngrohur përsëri.

Mirëmbani frigoriferin dhe ngrirësin

Vendosni temperaturën në nivelet e duhura: 3–5°C për frigoriferin dhe -18°C për ngrirësin. Mos e mbingarkoni frigoriferin dhe kontrolloni që dera të mbyllet mirë.

Mbushni plot lavastoviljen

Përdorni lavastoviljen vetëm kur është e mbushur plot, por pa e tejngarkuar. Një cikël i plotë është më ekonomik sesa disa larje të pjesshme.





Si të shmangim energjinë e humbur në kuzhinë?

Kjo checklist shërben si udhëzues praktik për familjet për të kuptuar cilat veprime të thjeshta ndihmojnë në kursimin e energjisë në kuzhinë.

Ajo mund të përdoret si kujtesë për kontroll të vazhdueshëm në shtëpi. Sa herë që familja kontrollon zakonet e përditshme, mund të rikthehet te lista për të parë nëse veprimet po zbatohen rregullisht.



Checklist për familjet

Çfarë duhet bërë për të kursyer energji në kuzhinë?

 Çfarë duhet bërë	 Pse ndihmon?	 U krye?
1.  Gatuaj me kapak sa herë është e mundur	 Kapaku ruan nxehtësinë dhe ul kohën e gatimit	☐
2.  Përdor enë që përshtaten me madhësinë e pllakës	 Shfrytëzon me mirë nxehtësinë dhe shmang humbjet	☐
3.  Mos e hap shpesh derën e furrës gjatë gatimit	 Ruhet temperatura dhe furra konsumon më pak	☐
4.  Mbaj frigoriferin në 3–5°C	 Ruhet ushqimi pa energji të tepërt	☐
5.  Mbaj ngrirësin në -18°C	 Pajisja punon me efikasitet optimal	☐
6.  Kontrollon që dera e frigoriferit mbyllet mirë	 Ajri i ftohtë nuk humbet dhe pajisja punon më lehtë	☐
7.  Përdor lavastoviljen vetëm kur është plot	 Kursen ujë, energji dhe kohë	☐

Quiz: Ku humbet energjia në shtëpinë time?

Ky quiz mund të bëhet nga e gjithë familja. Lexoni pyetjet së bashku, zgjidhni përgjigjen e saktë dhe më pas kontrolloni rezultatin. Qëllimi nuk është vetëm të gjeni përgjigjet, por të kuptoni çfarë mund të ndryshoni në shtëpi.

- 1 Para se të dilni nga shtëpia, cili është veprimi më i mirë?**
 - A. Të lini TV dhe dekoderin në standby
 - B. Të fikni plotësisht pajisjet që nuk përdoren
 - C. Të lini karikuesit në prizë
- 2 Kur gatواني, çfarë ndihmon më shumë për të kursyer energji?**
 - A. Të gatواني me kapak
 - B. Të hapni shpesh kapakun dhe derën e furrës
 - C. Të përdorni gjithmonë temperaturën maksimale
- 3 Cila temperaturë është më e përshtatshme për bojlerin?**
 - A. 40°C
 - B. 55–60°C
 - C. Sa më e lartë të jetë e mundur
- 4 Çfarë ndodh kur dritaret dhe dyert kanë çarje?**
 - A. Shtëpia ajroset më mirë gjatë gjithë ditës
 - B. Hyn ajër i ftohtë dhe humbet nxehtësia
 - C. Nuk ka ndikim në faturë
- 5 Cila është mënyra më e mirë për ndriçim efikas?**
 - A. Të përdoret drita natyrale dhe llamba LED
 - B. Të lihen dritat ndezur gjatë gjithë ditës
 - C. Të përdoren vetëm llamba të forta
- 6 Çfarë duhet bërë me karikuesin kur telefoni nuk po karikohet?**
 - A. Të lihet në prizë
 - B. Të hiqet nga priza
 - C. Të vendoset në standby



Ke përfunduar gjysmën e sfidës!



Vazhdo në faqen tjetër...



Zbulo nëse je një ekspert i kursimit të energjisë në shtëpi.

Quiz: Vazhdo sfidën!

Ke përfunduar pyetjet e para. Tani kontrollo sa mirë i njeh zakonet që lidhen me frigoriferin, pajisjet për ngrohjen dhe ftohjen dhe kursimin afatgjatë në shtëpi.

Lexo pyetjet 7–10, zgjidh përgjigjen e saktë dhe në fund kontrollo rezultatin e familjes.

7 Çfarë tregon një frigorifer që nuk mbyllet mirë?

- A. Që punon më lehtë
- B. Që humbet ajër të ftohtë dhe konsumon më shumë
- C. Që nuk ka nevojë për kontroll

8 Kur duhet përdorur lavastovilja?

- A. Kur është pothuajse bosh
- B. Vetëm kur është plot
- C. Sa herë ka një pjatë të palarë

9 Cili është rregulli më i mirë për ngrohjen dhe ftohjen?

- A. Të përdoren temperatura ekstreme
- B. Të përdoren temperatura optimale dhe të izolohet banesa
- C. Të hapen dritaret ndërkohë që pajisja është ndezur

10 Cili është zakoni më i thjeshtë për të kursyer çdo ditë?

- A. Të kontrollohen pajisjet, dritat dhe prizat
- B. Të përdoren më shumë pajisje njëkohësisht
- C. Të mos kontrollohet fare konsumi



Kontrollo përgjigjet, zbulo kursimin

Kontrolloni përgjigjet e sakta dhe numëroni rezultatin e familjes. Rezultati ju ndihmon të kuptoni cilat zakone të kursimit të energjisë i zbatoni mirë dhe cilat mund të përmirësohen në shtëpi.



Zbulo si shkoj quiz-i

Kontrolloni përgjigjet e sakta dhe rezultatin e familjes.



Përgjigjet e sakta

1. B

2. A

3. B

4. A

5. B

6. B

7. B

8. A

9. B

10. A



Rezultati i familjes



8-10

përgjigje të sakta

Familje kursimtare



5-7

përgjigje të sakta

Jeni në rrugë të mirë



0-4

përgjigje të sakta

Ka ende zakone për të përmirësuar



Çdo përgjigje e saktë është një hap më afër një shtëpie më efikase dhe një fature më të ulët.

Sfida: Gjej, Fik, Kurse

Përdoreni këtë checklist pas quiz-it për një kontroll të shpejtë 3-minutësh në shtëpi. Lexoni çdo pyetje dhe shënoni kutinë përkatëse kur veprimi është kryer. Në fund, kontrolloni rezultatin për të kuptuar sa mirë po zbatohen zakonet e kursimit të energjisë në familje.



Sfida e familjes

Kontrolli 3-minutësh

Pas quiz-it, bëni një kontroll të shpejtë në shtëpi.

Nr.	Pyetja	U kontrollua?
1. 	A janë fikur dritat e panevojshme?	☐
2. 	A janë fikur pajisjet në standby?	☐
3. 	A janë hequr karikuesit nga priza?	☐
4. 	A është bojleri vendosur në temperaturë të përshtatshme?	☐
5. 	A mbyllen mirë dritaret dhe dera e jashtme?	☐
6. 	A është frigoriferi në temperaturën e duhur?	☐

Mbështetja dhe Financimi

Si mund të financoni përmirësimet energjetike në shtëpinë tuaj?

Programet Kombëtare

Agjencia për Efiçencën e Energjisë

 eficenca.gov.al

Plani Kombëtar i Rinovimit të Ndërtesave :
fokus ndërtesa shumëfamiljare para viteve '90

Bashkia Elbasan - Projekti GreenElb

- ✓ Auditime energjetike
- ✓ Rekomandime teknike për izolim
- ✓ Orientim drejt financimit
- ✓ Ndërgjegjësim familjar

 054 400 152

 bashkiaelbasan@elbasani.gov.al

Kreditë e Gjelbra - GEEF

Program i EBRD dhe Bashkimit European për familjet në Ballkanin Perëndimor

Masa	Shembull
 Izolim termik	Mure, çati
 Dritare energjetike	Xham dopio/triple
 Pompa nxehtësie	Ngrohje/ftohje
 Panele diellore	Energji diellore


Bankat partnere të GEEF Albania:

ProCredit Bank Albania

Union Bank Albania

Intesa Sanpaolo Bank Albania

 ebrdgeff.com/albania



Familjet në Elbasan mund të përfitojnë nga kreditë e gjelbra të GEEF

Bashkia Elbasan · Projekti GreenElb · ebrdgeff.com/albania · eficenca.gov.al

Çmime · Subvencione · Hapat · Burimet Lokale

⚡ Çmimi i Energjisë 2026

8.5

lekë/kWh

Deri 700 kWh/muaj

9.5

lekë/kWh

Mbi 700 kWh/muaj

Burimi: ERE — Enti Rregullator i Energjisë 2026

☀️ Subvencionimi GEFF

20%

Grant BE

- Grant BE (20%)
- Kredia (80%)


* Panele diellore uji

Subvencionim për
ngrohjen e ujit
eficenca.gov.al

🏠 Grant GEFF 20%

Grant pas instalimit
teknologjive
ebrdgeff.com/albania

Si të Aplikoni - 4 Hapat Praktikë



📍 Burimet Lokale në Elbasan



Materiale Izoluese

EPS · XPS · Lesh guri · Silikon · Shirit izolues

📍 Tregjet lokale Elbasan



Dritare PVC / Al

Xham dopio · Triple xham · Korniza me izolim

📍 Kompani lokale Elbasan



Instalues GEFF

Panele · Pompa · Izolim · Instalues të verifikuar

🌐 ebrdgeff.com/albania



Potenciali i Kursimit me këto Masa

Ndriçim LED

75%

Ngrohje/Ftohje

30%

Dritare/Çarje

20%

Pajisje/Standby

10%

💡 **Ndërhyrje të thjeshta kursejnë 15–25% të energjisë në çdo familje**

Bashkia Elbasan · GreenElb · 054 400 152 · bashkiaelbasan@elbasani.gov.al · eficienca.gov.al

Plani Personal i Veprimit: Masat

1. Masat që do të zbatoj këtë muaj



Nr.	 Masa	 Data e fillimit	 Kosto (LEK)	 Kursimi (kWh)	 Kursimi (LEK)
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Plani Personal i Veprimit: Progresi

2. Ndjekja e progresit – 3 muaj



 Masa	 Muaji 1	 Muaji 2	 Muaji 3	 Shënime
	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	
	☐	☐	☐	

Plani Personal i Veprimit:

Reflektim

3. Reflektimi i shkurtër



Cila masë
funktionoi më mirë?



Çfarë kursimi
vura re?



Si do ta ndaj
këtë përvojë me familjen,
fqinjët ose komunitetin?

Përmbledhje



Totali i kursimit (kWh):



Totali i kursimit (LEK):

Referencat

Urban Research Institute. 2025. Studim mbi sjelljen e konsumit të energjisë në Elbasan: Nga familjet te veprimi klimatik. Projekti GreenElb, WP2, A2.1.1, D2.1, SGA NZC 101121530.

Urban Research Institute. 2025. *Analiza dhe përzgjedhja e pesë sjelljeve prioritare të banorëve në përdorimin e energjisë*. Projekti GreenElb, WP2, A2.1.2, D2.1.2, SGA NZC 101121530.

Urban Research Institute. 2026. *Përmirësimi i efikasitetit energjetik të banesave përmes ndryshimit të sjelljes: Dizajni i ndërhyrjeve dhe plani pilot*. GreenElb Programme, WP2, D2.1.2, SGA NZC 101121530, Subgrant PCP3.

Bashkia Elbasan. 2026. *Raporti i Auditimit Energjetik për Lagjen Vullnetari*, Bashkia Elbasan. Elbasan.

Bashkimi Europian. 2021. *Energy Performance of Buildings Directive, EPBD*. EUR-Lex, SWD(2021) 453 final.

DIN. DIN V 18599-10: *Energy efficiency of buildings - Calculation of energy needs, delivered energy and primary energy*.

Republika e Shqipërisë. 2015. *Ligji nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë"*. Republika e Shqipërisë. Legjislacioni shqiptar për efikasitetin e energjisë dhe performancën energjetike të ndërtesave.



Kontaktet e Projektit GreenElb



Bashkia Elbasan
054 400 152



Email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al



www.uri.org.al



Funded by
the European Union



BASHKIA
ELBASAN



URBAN
RESEARCH
INSTITUTE



Funded by
the European Union



BASHKIA
ELBASAN



UR
URBAN
RESEARCH
INSTITUTE